

ALBAN TUFA
PO SIKUR TË MOS JETË ËNDËRR?

Roman

BOTIMET TOENA

ALBAN TUFA

PO SIKUR TË MOS JETË ËNDËRR?

Roman

BOTIMET TOENA

Tiranë

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Edona Marku Huqi

Redaktor letrar: Agron Tufa

Përkujdesja grafike dhe kopertina: Erdita Oshafi

ISBN 9789928817631

© Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjete ose forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja" nr. 71, Tiranë 1023.

Kutia Postare 1420

E-mail: botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

<https://toena.al/>

I

ZËRI I KËNDSHËM, NUK ËSHTË DHE AQ I KËNDSHËM

Si kurrë më parë, nga dritaret e hapura të dhomës së gjumit nuk po dëgjohej më kurrfarë uturime makinash, as rrapëllima e betonierave dhe vinçave të ndërtimit, as vizgëllimat therëse të avionëve, as kërkëllimat troshitëse e cijatëse të tramvajit që, kur çante mes për mes qytetit, të bëhej se të shitonin pabesisht me heshtë, brinjë më brinjë; nuk ndihej më as poterja e fëmijëve në Parkun e Gjelbër, e cila ta priste si me elmaz qelqin e trurit, pas çdo lindjeje dielli: asnjë zhurmë tjetër, përpos cicërimave të trumcakëve që sapo uleshin në parvazin e dritareve, mëtonin sakaq të futeshin brenda. Ta kishte në dorë ai, do t'i kishte lejuar, por s'i dha dot dum se ç'forcë komandonte. Nuk e mbante mend ta kishte hapur dritaren; me t'i hyrë në krye ky mendim brofi në këmbë. Sapo hodhi hapat e parë drejt derës, pati një turbullirë e marramendje, sa, po të mos qe mbajtur pas dorezës së gardërobës, gjunjët, me gjasë, do ta kishin lëshuar e tash do të dergjej në dysheme. Vetëm kur provoi ta hapte derën dhe ajo nuk iu bind, iu zhdavarit dyshimi se mund të ketë hyrë ndokush brenda, së paku prej

mbrëmjes së kaluar. Ktheu sërish kokën nga dritarja hapur kanatesh, këqyri një çift trumcakësh të ulur krejt lirshëm në parvaz. Ata sikur gjakonin diç t'i kumtonin me cicërimat e tyre, por pasi u bindën që, tash për tash, me të nuk po merreshin dot vesh me atë gjuhë, rrahën flatrat dhe u lëshuan në qiellin e pamat të atij mëngjesi të kthjellët pranveror.

Kur po kthehej të shtrihej sërish në shtrat, sytë i shkuan mbi cepin e komosë. Në fund të saj vuri re Kutinë me ngjyrë të verdhë me fishën e futur në të, i cila lëvarej poshtë komosë derisa arrinte të cikte lehtë dyshemenë prej pllakash. Shpuri ngutazi dorën në xhepin e pasmë, por nuk e kishte aty, e fill, kaloi dorën pas qafe dhe kërkoi fishën e Kutisë me tahmin, por as atë s'e gjeti. E solli mandej vrik dorën pas veshi dhe preku dregëzën e krijuar, me gjasë, nga shqepja e fishës. U lëshua me ngut, e mori Kutinë në duar dhe e mbajti në grusht, sikur të kishte kapur zemrën e dikujt, sikur gjaku që i rridhte çurg të imitohej nga fisha e zgjatur, që luhatej si lavjerrës. Me ta bërë këtë gjest prej njeriu robot, ngeli si i shtangur: trupi iu rrëqeth, ndërkaq që, sa herë vështronte fishën tek luhatej poshtë duarve të veta i shkaktohej një si marramendje e frikshme dhe herë-herë madje i trazoheshin të vjella. Në pamundësi për të rrokur me mend rrethanën ku ndodhej, logjikën e kronologjisë se si kishte mbërritur deri në këtë gjendje, deri në këtë rrethanë të pazakontë, të pakapërdishme madje, filluan pak e fije t'i dridhen njëkohësisht duart dhe gjunjët.

Me Kutinë në dorë, pa lëvizur nga pozicioni ku qe, hodhi sytë matanë dritares në Parkun e Gjelbër; fëmijët kishin nisur lojërat e tyre, lëshonin tek-tuk ndonjë piskamë, por atëbotë ai qe bërë krejt shpërfillës ndaj tyre. U përpoq, kësisoj, ta sundojë vetë gjendjen, andaj mori sakaq fishën që lëvarej dhe e shtiu në folenë e vet fill pas veshit. Pasi e pështolli fishën kular rreth qafës, e shtiu fundin e saj, tok me Kutinë, në xhepin e posaçëm.

Tashmë nuk i zinte besë idesë se, natën e kaluar, kishte qenë i vetëm në dhomën e tij të gjumit: sa herë që gjakonte të kujtonte çastet e hapjes së dritares, të heqjes së fishës dhe shkëputjes së Kutisë prej vetes, mendja nuk i ruante kurrnjë gjurmë të këtyre veprimeve, qoftë dhe në trajtë fragmentesh të ndonjë veprimi të kryer. Pasi e vendosi Kutinë, shtypi butonin e kujtesës: ajme! Imazhet që iu shërbyen qenë turlifarësh, veç çka priste Arsini¹²³; ato nuk u shfaqën. Kjo e bëri të bindej përfundimisht, se nuk kishte qenë i vetëm. Si hapja e dritares, si shkëputja e Kutisë nuk ishin kryer prej tij, ngase, së pari, Kutia nuk kishte kurrfarë të dhënash të tilla, dhe, së dyti, ai me arsye dhe vetëdije të plotë nuk do t'i kishte kryer vetë. Ai e dinte më së miri, se fill pas kësaj, dënimi do të qe i padiskutueshëm.

“Por çfarë të ketë ndodhur?”, pyeti veten në kulmin e habitës.

“Do të jesh çmendur”, u përgjigj po vetë, me ngut dhe me bindje të plotë.

“Domethënë, të është prishur Kutia. Do të jetë çakërditur programi i saj”, e vazhdoi përgjigjen duke korrigjuar.

“Ç’aftësi të çuditshme ka njeriu për të korrigjuar veten!”, e mbështeti mendimin e vet me shpoti.

“Jo, jo, njeriu në ka aftësi të mira, më të mirën e ka për të nxjerrë justifikime”, e kundërshtoi veten pa kurrfarë zori.

“Sigurisht që po çmendem ose kjo gjëja ka pjerdhur”, tha duke e parë fishën që zbriste përposhtë e shkonte në xhepin e posaçëm.

“Si t’ia bëj tash?”, pyeti veten.

Fill pas kësaj, pati bindjen se duhej marrë masa se s’bën.

“Në sektor! Shko, dorëzo Kutinë!”, i dha urdhër vetes.

Ende pa u shuar jehona e kësaj ideje, mori vendim të nisej.

Në këto përsiatje e sipër, ndërsa përpiquej të vishte kostumin e zi prej plastike të gomuar, vuri re mbi tavolinën e punës një bllok shënimesh me një kopertinë të zezë. Kur e mori në dorë tekstura e saj i dha një ndjesi rrëqethjeje, ngaqë kopertina ishte prej lëkure. Për ta përshpejtuar këtë çast, ai e kapi me ngut në anën e brendshme të kopertinës dhe lexoi të shkruar me ngjyrë blu, me një shkrim të spërdredhur, “Ivana123”, dhe fill më poshtë “Shënime që duhen djegur”. Shkrimi nuk iu duk i zakonshëm, madje nuk e kishte hasur kurrë më parë

këtë metodë shkrimi, por ngaqë në thelb gërmat nuk ndryshonin nga ato që na paraqet Kutia, tek e fundit ia doli t'i lexonte.

“Kush dreqin na qenkësh kjo Ivana”, mendoi, “ç’dreqin do në dhomën time ky bllok dhe ç’dreqin të ketë brenda?”

“Shiko Arsin”, i tha vetes teksa për herë të parë në jetë harroi të përmendte kodin 123, “ke shtruar tri pyetje që fillojnë me *dreqin*, kështu që pse nuk i jep përgjigje kësaj pyetjes sime: ç’dreqin je duke bërë?”

“Kësaj pyetjeje mund t’i përgjigjem vetëm me një pyetje: Ç’dreqin po më ndodh?”

“Shiko”, i tha vetes, “që ta kuptosh se çfarë po të ndodh, duhet që t’i shohësh gjërat me ngadalë, të mësosh së pari se ku je”.

“Ku jam? Si ku jam?! Jam në dhomën time, në mëngjes, i sapozgjuar nga gjumi, dhe pasi e kam gjetur dritaren hapur, gjë e cila nuk duhej bërë kurrësi, pasi e kam gjetur Kutinë, pra *Kujtesën* time të lënë mbi komo, gjë e cila as kjo kurrësi nuk duhej bërë, dhe e treta, pasi kanë futur një bllok të huaj të një njeriu të huaj në shtëpinë time (dua të them në shtëpinë tonë), gjë e cila, as kjo, kurrën e kurrës nuk duhej bërë, po rri si hut duke e mbajtur në dorë, a thua se kam fituar trofeun e *Konkursit të Vullnetit* të organizuar nga Zëri i Këndshëm.

Të gjitha këto ia tha vetes si një formë të merituar vetëndëshkimi.

“Kjo është një situatë që do ta kesh krijuar vetë, sepse derën e ke në çelës, mundësitë që të jetë futur dikush brenda në dhomë shumëzoi me zero, por më mirë fillo e lexo: çka dreqin ka brenda atij blloku?”, e urdhëroi veten tash, në formë të prerë.

Pa bëzajtur, hapi faqen e parë të bllokut dhe pasi këqyri tri yje të vizatuara si mos më keq, kaloi te rreshti i parë i shkrimit:

Zëri i Këndshëm, nuk është dhe aq i këndshëm. Madje ka zëra edhe më të këndshëm. Ose më saktë: *Zëri i Këndshëm* nuk është aspak i këndshëm, është zë i shpifur.

Këto fjalë e trullosën me tërësej. Sytë iu errën dhe trupi filloi t’i dridhej sikur ta kishin vënë në karrigen e ndëshkimit. Dhe mandej, pasi e ledhatoi veten me argumente nga më të çuditshmet, që nga idiotësia që dikush mund të mbajë të tilla gjëra, deri tek ideja që do ta përcillte këtë bllok në sektor dhe le të merrej vetë *Zëri i Këndshëm* me të dhe me pronarin e këtij blloku, e kapërceu disa faqe më tej dhe lexoi:

*Ky vend, është një vend ku nuk jetojnë njerëz, por robotë, robotë që nuk kanë kurrfarë individualiteti, robotë që i përgjigjen me përpikmëri të frikshme çfarë iu përcjell *Zëri i Këndshëm* nëpër Kutë. Një popull që nuk ka as tru, as mend, as kujtesë, që edhe nëse u kërkon të hanë të pëgërën e vet, ata do ta bëjnë me vullnet.*

Kjo ia rriti tensionin dhe turbullirën më shumë dhe pa e kuptuar as vetë se çfarë po bënte me të, kaloi në disa faqe të tjera.

Pse duhej që të pritëshin pemët dhe të zëvendësoheshin nga plastiket? Për një arsye themelore, që njeriu, pra, ky robot prej mishi - të ishte i dobët dhe i varur krejtësisht nga Zëri i Këndshëm. Sa më të fortë ta ketë njeriu lidhjen me natyrën aq më pak do të ketë nevojë për pushtetin. Në të kundërt sa më të dobët ta ketë lidhjen me natyrën, ai, pra, njeriu, jo vetëm që do të jetë më i dobët, por do të ketë nevojë të padiskutueshme për pushtetin ose më saktë nuk do të jetojë dot pa të.

Meqë çdo pjesë që po e lexonte po ia trulloste më keq kokën, duke u bërë ndërkaq gjithë e më sfiduese, ai kaloi në një nga faqet e fundit.

Problemi më i madh nuk është që njerëzit nuk po mbajnë mend asgjë nga e shkuara, por fakti që njerëzit e kanë humbur tashmë edhe mundësinë për të mbajtur mend, ngaqë rutinat e tyre nuk ndërtohen më mbi mendjen dhe kujtesën njerëzore, por mbi Kutinë dhe kujtesën algoritmike. Kjo bën që, nëse do t'u fshish të shkuarën, këtë mund ta bësh lehtësisht, mjafton që të kesh qasje te këto të dhëna, ose tek e fundit, mjafton që t'i teket Zërit të Këndshëm.

Me të sosur këto fjalë Arsini¹²³ u pështjellua keqas dhe në mënyrë krejt automatike e palosi bllokun me forcë, mbyllja e të cilit dha një kërcitje të fortë. Kur e

mbylli duke këqyrrur mbi kapak vërejti se mes emrit të bllokut dhe emrit të tij - ishte i përbashkët mbiemri "123".

Bash në çastin kur nisi të mendonte mbi këtë përkim, mbi këtë të dhënë domethënëse, plasja e një shpërthimi, të ngjashëm me një bombë, sa nuk i çau veshët.

- Policia! - ia dhanë britmat e të çjerrat e disa zërave njëherësh, të cilat u përzien me zhurmën e përplasjes së derës dhe kafshimin e ashpër të çizmeve të rënda të policëve në dysheme. Për punë sekondash, ai nuk po i jepte dum se ç'po i ndodhte. Tek e fundit ky mëngjes kishte qenë krejt i çuditshëm dhe i beftë, andaj s'ishte çudi që vazhdimi të sillte gjithfarë të papriturash përgjatë ditës.

- Duart prapa! Bjer në gjunjë! - ia dha thershëm piskama e katër policëve, që tashmë kishin hyrë në dhomë.

- Edhe dorën tjetër! - u dëgjua të thoshte njëri nga policët, që ia kishte vënë njëren dorë në pranga.

- Kujdes Kutinë! - i tha njëri kolegut të vet.

- Kapja bllokun! - tha një tjetër.

Ndërkaq para syve të Arsini 123, u shfaq një police me kokore të vënë në krye, xhami i errët i së cilës ia ndalte depërtimin e shikimit për te fytyra e saj. Ajo u përkul krejt e shkujdesur dhe kapi bllokun e shënimeve me kapakë të zinj. Njësoj, si e zeza e kapakëve edhe e zeza e uniformës së saj, shkruante diku mbi gjoks, në një etiketë të zverdhët: Ivana123.

Edhe pse i pataksur, Arsini123 u rrek t'ia shquante fytyrën. Mëtoi të kapte së paku ndonjë element që mund t'i shërbente për të kuptuar diç, çfarëdoqoftë ose nga kushdoqoftë, përpjekje të cilat i rezultuan krejtësisht të pavlefshme.

Ashtu, i dorëzuar dhe pa kurrfarë tentative për të kundërshtuar, të dy policët të cilët e kishin kapur për krahësh të udhëhequr nga kolegia grua, e ngjitën në makinën fluturuese që e nisi drejt e në sektor, e pastaj fill te Zëri i Këndshëm.

Në këtë çast Arsini123, në një frymëkëmbim të shpeshtë a thua se frymëmarrja dhe frymënxjerrja po i ngatërroheshin në lukth, u zgjua nga gjumi. Teksa u përpoq të rregullonte frymëmarrjen, preku ballin dhe dora iu lag nga djersët që i shkonin çurg.

U çua me të shpejtë, pa Kutinë mbi komo dhe me ngut e mori fishën dhe e rراسi pas veshi, mori bllokun me kapak të zi dhe e fshehu mes rrobave në gardërobë, dhe duke rikujtuar cicërimat e zogjve në dritare, ia këputi sërish një gjumi të thellë, a thua se vdekja dhe ai gjumë të mos kishin pikën e ndryshimit.

SAPO TË ZBRES NË PARK E GJITHA DO TË KALOJË

Ç'të qe e gjitha kjo? Një makth? Një çudi që i është shpifur nga një botë e përkundërt e nxitur nga kushedi se cili hakmarrës. Nuk kishte parë kurrë me parë një ëndërr, madje as kishte ndier turbullirën më të vogël përgjatë gjumit. I kishte qëndruar besnik kësaj rrjedhe të gjërave, pa u dalë në shmang, qoftë edhe pavetëdije. Kjo qe hera e parë që e kapte veten duke menduar kaq gjatë dhe kaq thellë tek përsiatej mbi një ngjarje. Ishte shastisur me veten se si një njeri në Qytetin e Blertë mund të shihte diçka jashtë ekranit dhe jashtë botës *reale* e sakaq këtë ta bënte në mënyrën më absurde, me sy mbyllur. T'i kishte me të vërtetë sytë e mbyllur? E nëse po, atëherë si u shpërfaqën në sytë e tij ato imazhe të njëpasnjëshme, duke u dhënë pamje pas pamje si në një ekran.

Pasi u përsiat për pak çaste, në mend i erdhën cicërimat e zogjve, zhurmat e shqyerjes së derës dhe britmat e policëve duke i kërkuar me të madhe që të vinte duart pas koke. Si të mos mjaftonin imazhet e shpërfaqura, çudia na paska përzier edhe zërin. Pra, me sytë e mbyllur edhe paska parë, edhe paska

dëgjuar, dhe kur - në thellësi të gjumit, në atë gjumë që është më i ëmbli - gjumin e mëngjesit.

Por, dreqin, mos e gjitha kjo nuk ishte një fantaksje, por të kishte ndodhur me të vërtetë, të kishte ndodhur me të vërtetë këtë viran mëngjesi, e sakaq e gjitha të ishte tash një e shkuar. Po sikur të ketë qenë po aq reale sa çdo çast i jetës së tij? Këto i shkuan ndër mend për sa dergjej shtrirë në shpinë në krevat, në të vonë të asaj paraditeje. Mendoj që e gjitha ajo çka përjetoj në mëngjes të kishte qenë reale, por ndërkaq, nëse kjo e gjitha të paskësh qenë reale, atëherë pse nuk vazhdonte të ndodhte? Dhe nëse ai ishte me pranga në duar, pse nuk i kishte më? Ta zëmë se ia hoqën ato prej duarsh, kush ia hoqi? Dhe nëse kjo ishte aq reale me policët që sulmuan derën, si ka mundësi që prindërit nuk u përzieren asfare në këtë ngjarje, së paku të dukeshin në dhomë ose së paku ta kishin ndjekur kur doli për në Park? Sigurisht që jo, nuk e gënjente kurrë logjika, e aq më pak kronologjika.

Në këtë mjegulli dhe me të njëjtën ndërdyshje ose ndërtrashje, (apo më keq me të njëjtën ndër të pafundme dhe të çdofarshme) u ngrit me idenë që, një dush i nxehtë mund ta kthjellonte, se me heqjen e djersëve, përthithjen e ujit të shkumuar, përzierjen e tyre me ujërat e zeza, do të binin, zhyteshin nën gypin thithës të ujërave, do të shkonin në kanalizime edhe mendimet e tij të turbullta ose më saktë jo krejt mendimet e tij, por së paku turbullira, forma e tyre ndërdyshëse. E gjitha që veçse një dëshirë e çastit, që edhe pse aq e vogël dhe e arritshme, ajo mbeti e

tillë. E njëjta turbullirë, i njëjti sëmbim se mos kjo fantaksje po e shpinte në zona të mjegullta atë bashkë me Kutinë, e shoqëroi teksa u fut në banjë, edhe kur la Kutinë bashkë me fishën mbi raftin që gjendej te pasqyra, edhe kur liroi saraçineskën për të rrëshqitur uji, edhe kur shkumoi kokën, edhe kur fërkoj me gishta anash *inputit*, aty ku fisha futej mbas kreje, edhe kur uji i gjithi rrodhi bashkë me shkumën dhe përshkuan tubacionet, edhe kur fërkoj aletet e veta, edhe kur për një çast u përpoq të kujtonte Ivana123, gjë e cila siç pritej nuk ndodhi, ngaqë nuk mund të rikujtohej, sepse të gjitha kujtimet me të ishin të regjistruara te Kutia dhe ajo tash e parë gjendej në raft. Sigurisht, por për habinë e tij, i njëjti sëmbim e shoqëroi edhe teksa po vishej, aq sa njëra këmbë kostumi gome i dukej një mundësi e tjetra i dukej si mundësia tjetër, njëri krah i dukej njëra, ndërsa krah tjetër i dukej tjetra mundësi. Të njëjtën turbullirë e ndjeu edhe kur hëngri mëngjesin me ushqimin e tij të preferuar, fruta të koncentruara dhe salsiçe me mish laboratorik; edhe kur u tha prindërve që do të dilte në Park; edhe kur zbriti me ashensor; edhe kur plaka Garbi321 e përshëndeti për së pari herë me një buzëqeshje që nuk ia kurseu të bardhën e protezave, si e bardha e fishës së Kutisë së saj diku pranë veshit. Këtu mendimi iu dendësua, jo mendimet në përgjithësi, por i njëjti mendim, i njëjti mendim se ai po çmendej, ose se bota do të kishte pësuar një çrregullim të pakthyeshëm.

Si mundet që pas kaq vjetësh bash sot kur po ndodhin gjëra të çuditshme plakës Garbi 321 t'i kthehet buzëqeshja? “Ja që mundet, - i tha vetes dhe fill arsyetoi: - Sapo të zbres në Park e gjitha do të kalojë.” Tek e fundit një ecje e fortë do t'i djegë të gjitha mendimet negative.

Me këtë ndërzymje që e ndiqte si një tufë mizash përreth kokës, u dha me njëfarë përtese në mesin e Sheshit të të Vjetërve, duke marrë përsikaj shatërvanit, kaloi te Statuja e të Ardhmes. Në fakt statuja nuk ishte me të vërtetë statujë, por një monument, njëfarë kuboidi i ngritur vertikal, njësoj si një kuti shkrepëse ose njësoj si një tullë (në këtë rast krahasimi mund të përcaktohet nga ngjyra), e meqë ngjyra e saj ishte e kuqe duhet thënë që ngjante më shumë me një tullë, e cila e kthyer kesisoj vertikalisht shënjon Kutinë. Me ta vështruar atë, në mend i erdhi Kutia, dhe fill pas kësaj, mendimi që e pasoi ishte sërish ajo shajni që kishte përjetuar në mëngjes.

Në fakt të gjitha ndërtesat në Qytetin e Blertë kishin të njëjtën formë kubike dhe përnjëmend të bëhej sikur i gjithë ky qytet ishte një arkë e madhe e mbushur me kuti shkrepësesh të hedhura krejt rastësisht, ku në mënyrë të habitshme të gjitha kishin rënë e ishin ngulur në të vertikalisht. Të gjitha ato Kutitë gjigante atë mëngjes i trazonin vetëm turbullirë. Të njëjtën gjë i shkaktonin edhe godinat më të rëndësishme të qytetit, e për rrjedhojë dhe të kombit. Të njëjtën gjë i shkaktoi edhe godina e Shterpimit të Mendjeve, edhe godina e Ngjarjeve të Reja, edhe godina e Prodhimit

të Kutive, e për pasojë edhe godina e Prodhimit të Fishëve, godina e Trajnimeve të Përdorimit, godina e Shkollës së Re, si edhe godina e Zërit të Këndshëm, vetëm se kjo e fundit në një mënyrë pak më të veçantë, me njëfarë ndryshimi, disi më ngulmët, disi më e theksuar, sikur të qe një fjalë me *bold* në mes të një teksti.

Ndërsa ecte nëpër udhët e Qytetit të Blertë dhe sodiste godinat, rrugët, pemët prej plastike, xhamat reflektues të makinave fluturuese, dhe sidomos njerëzit, të cilët në mënyrë të përpiktë, që të gjithë, ecnin pa e kthyer kokën në ndonjë drejtim kundër apo së paku ndryshe nga ç'po lëviznin këmbët, ndërsa këqyrte në mënyrë të veçantë Kutitë dhe fishët e tyre, e zuri veten gafil disa herë duke shkuar nëpërmend gjëra nga më të çuditshmet.

Fillimisht mendoj se për ku qenë nisur të gjithë ata njerëz që po ecnin në drejtim të Sheshit të të Vjetërve? Po ata që ecnin në drejtim të kundërt për te Sheshi i të Ardhmes? Ku shkonin ata me aq ngut? Çfarë i shtrëngonte të mbanin atë drejtim shikimi? Mandej papritmas i mendoj ata njerëz për një grimë duke mos ecur, të ngrirë shtang, njësoj siç ngrijnë njerëzit në ekrane kur i ndalim teksa po shohim një film. Kjo ide ia paralizoi mendjen, ose më saktë: ideja që kjo ide mundë të mendohej, madje krejt pa zor, në heshtje. Pasi e provoi sërish t'i mendonte njerëzit të ngrirë, arriti në përfundimin se këtë mund ta bënte sa herë të donte, madje pa ia marrë vesh askush në botë.

Gjithë turbullirës dhe shastisjes në mëngjes iu shtua edhe kjo ide e beftë se njerëzit mund të ngrijnë për një çast ose së paku mund ta mendosh këtë, gjë e cila i shkaktoi një rrëqethje përgjatë gjithë kurmit. “Kësisoj vjen shkallimi, - i tha vetes, - s’ka ndonjë ceremonial më të madh se kaq dhe shenjat tashmë më janë bërë me dije”.

Tek rrekej të bindte veten që shkallimi nuk vjen me ndonjë formë më demonstrative se kaq, turbullirat e shkaktuara në stomak erdhën e iu ngjitën në grykë, derisa u shtrëngua të shmangej pak e të shprazte të vjellat mbi barin e gjelbër plastik. Krejt instinktivisht kërkoi me duar një stol dhe për fat anash tij gjendej një stol plastik, por në dukje si prej druri (çfarë imitimi perfekt) dhe u ul në të.

Pasi fshiu buzët me mëngën e kostumit prej gome, u shkreh i gjithi. Me sytë gjysmë të mbyllur, a thua se po përpiquej të komunikonte me një botë të përtejme, ose sikur të qe në një objekt kulti, nxori gjithë ç’pati në përbrendësa dhe mendoj. Mendoj dhe ashtu, nëpër dalldinë e kësaj kllapie, diç kuptoi, se jeta e tij tash për tash kishte marrë pakthyeshëm një tjetër drejtim, se do të ndahej tashmë në dy periudha, atë para dhe atë pas këtij mëngjesi. Sakaq në mënyrë krejt instiktive çoi dorën pas qafe dhe e shkëputi fishën prej vetes me një gjest krejt të beftë e inatçor.

KËTO GJËRA NUK MËSOHEN NË SHKOLLË

- Nuk e di çfarë po më ndodh. Kur u zgjova, më saktë, para se të zgjohesha ndaj të gdhirë, - një rrethanë shumë e pështjelluar, - më ngjau diç e habitshme: sa çela sytë, mbase... pak më parë (më parë se t'i çelja sytë), qeshë zgjuar, pak a shumë si çdo ditë, veçse kësaj here i kisha hapur kanatet e dritares, ndonëse mund të mos i kisha hapur (t'i kishte hapur, së këndejmi, dikush tjetër?). Pashë që kisha shkëputur fishën (apo dikush mund ta ma kishte shkëputur... e gjeta të shkëputur fishën bashkë me Kutinë), të lënë mbi komonë pranë krevatit. Të them të drejtën gjësendet m'u përziën, pak a shumë sikur futen në Kutitë viruset dhe sakaq rendet e gjërave dhe rrjedhat e ngjarjeve na tollovitën. Nuk di ta shpjegoj si mund të kenë ndodhur këto, ndërkaq që gjithë kohës Kutinë e kam pasur të shkëputur. Por sidoqoftë, ndërsa po merresha më Kutinë, ndërsa përpiquesha t'i jepja kësaj situate njëfarë domethënieje, njëfarë kuptimi, tek e fundit t'i shpjegoja vetes diç që kishte kuptim, pashë mbi tavolinë një bllok shënimesh me kapakë të zinj, me emrin tënd. Sigurisht që ky ishte blloku yt

që më pate dhënë atë ditë, kur para se të kalonim në Parkun e Gjelbër, u ndalëm bregut të lumit mbi Urën e Qelqtë. Sakaq e hapa bllokun dhe fillova të lexoja pjesë që nuk m'i rrokte mendja, e madje, as Kutia. Nuk i dhashë shumë rëndësi këtij fakti - më saktë, mendoj tani, që nuk i dhashë rëndësi këtij fakti dhe shkapërceva në disa fletë të tjera; as me ato çfarë ishte shkruar aty nuk mundesha të pajtohesh, ngaqë, siç të thashë, ato ide nuk m'i rrokte as mendja, as Kutia. Si të mos mjaftonte kjo, në dhomë, ndërsa po lexoja ato shënime, në derë u dhanë krejt papritmas disa policë të armatosur, të cilët, ta pret mendja, kishin ardhur të më arrestonin dhe, përpos kësaj, midis tyre gjendej edhe një police, pra një grua... Ta rrok mendja se kush?! Mes tyre, policja grua kishte emërtimin tënd. Gjë të cilës nuk mundem t'i zë besë se ishte ti.

Pasi u mbush me frymë disa herë, ia nisi sërish: - Nuk më habisin të gjitha këto ngjarje që mund dhe s'mund të kenë ndodhur, më shumë sesa më habit fakti që, të gjitha këto, unë i kam parë në një formë krejt të pamundur, në atë formë që njeriu nuk mund të shohë asgjë: më sy mbyllur. Ajo çka i vë kapak kësaj rrethane të koklavitur është fakti se, kur u zgjova, i pashë që të gjitha, - sosi Arsini123.

Fill pas këtij parashtrimi, i dha një të thithur ajrit, si të qe një fshesë me korrent: shpjegimi i gjatë ia kishte shteruar rezervën e ajrit në mushkëri.

Ivana123, vuri buzën në gaz, ndonëse përbrenda i vinte të qeshte me të madhe, andaj e ndrydhi atë

shpërthim gazi për të mos e fyer. Mandej, bash në momentin kur u mpreh t'i jepte përgjigjen e saj të shpejtë dhe të thukët, ai vazhdoi prapë të fliste:

- Dhe e di kush ia vë kapakun krejt kësaj situatë? Ndërsa vija këtu, shihja njerëzit në rrugë që ecnin si toptha letre të shtyrë nga era, mandej mendja ime apo me saktë, Kutia ime, ka gjasë të dyja ose asnjëra, më sugjeruan një pandehmë, një mendim, thjesht një ide, sepse bëra çmos ta zhduk sa më shpejt të qe e mundur, e që mund ta përmbledh kështu: sikur atë çast të gjithë kalimtarët në ecje e sipër të stepnin menjëherë, të ngrinin, fjala vjen si në atë lojën “ngriva-shkriva” që bënë dikur qeniet e lashta.

Kësaj here Ivana¹²³ nuk e mbajti dot të qeshurën që, edhe pse e mefshtë, shpërtheu jashtë.

- Pra, unë jam gati në të çmendur, në mos jam çmendur tashmë, dhe ti qesh? - tha ai me një ton prej të fyeri.

- Yha... sa ka gjer te çmendja! - tha ajo e më një siguri që të bënte ta besojë se vërtet ajo merr vesh nga këto çështje.

- Hajt de, ma shpjego se çfarë qe e gjitha kjo, meqë t'i mendon se i di mirë këto punë, - kërkoi Arsini¹²³ me një intonacion gjithë e në zbritje, aq sa fjala e fundit thujse nuk u dëgjua as prej tij.

Sigurisht ajo merrte vesh nga këto punë, dinte nga këto gjëra dhe shumë më shumë. Dhe pa humbur kohë, bëri një njomë, si bëjnë ca vajza stërnaze kur maten të thonë diçka me rëndësi; shmangu flokët anash, iu avit

më fort Arsinit¹²³ dhe, sikur t'i kallëzonte një krim, i tha nën zë:

- Ajo që ti ke parë nuk është as çmendje, as fantaksje; nuk është as ndonjë gjë e cila të ka ndodhur vetëm ty, madje asgjësend që nuk i ndodh njeriut në përgjithësi: nuk është hiç më pak e hiç më shumë sesa një ëndërr. Edhe ende pa mbaruar, ai ndërhyri me një pyetje që pritej:

- E çfarë është kjo?

- Është një pamje, një vizion, diçka që njeriu e sheh dhe e dëgjon ose më saktë është një përjetim. I ndodh njeriut në disa raste të veçanta, - tha ajo me ngut, sikur të kishte sajuar një përgjigje pak a shumë fillestare.

- Që është përjetim, kaq e kuptova, sepse ajo çka më ndodhi dukej krejt reale, njëfarësoj sikur atje në kinematë 7D, - tha ai, dhe sakaq e pyeti: - Po si mund të ndodhë e gjitha kjo?

-S'ë di, madhështi e Zotit, - tha ajo.

- Kush është Zoti? - pyeti ai.

- Ai që ka krijuar dhe ka nën kontroll gjithçka, -u përgjigj ajo.

- Edhe Zërin e Këndshëm? - pyeti Arsini¹²³.

- Pa dyshim. Edhe Zërin e Këndshëm, edhe nënën e Zërit të Këndshëm dhe krejt çka ka nën zotërim Zëri i Këndshëm dhe krejt Qytetin e Blertë, dhe krejt po deshe botën dhe universin. Gjithçka që ekziston dhe nuk ekziston, - sosi ajo teksa fjalët edhe pse me zë krejt të ulët merrnin një ritëm të fortë dhe të ngulmët,

që të dukej se të shponin trutë. Dhe teksa po i jepte fund këtij shpjegimi shtoi me butësi:

- Por ti nuk duhet ta ndash më askënd këtë që sapo të thashë.

- Për ëndrrat po thua, që i ka krijuar Zoti, për një gjë më të madhe sesa Zëri i Këndshëm? - u rrek të sigurohej më tej Arsini123.

- Ose truri ynë. Pra, mendja jonë. Duke u zënë ngushtë nëpër skutat e përditës dhe nga probleme që nuk i çan dot më tej, ngre kësisoj rrengjesh, pak rëndësi ka nëse je zgjuar apo fjetur, në këmbë apo shtrirë. E meqë Zoti na ka krijuar ne dhe bashkë me ne edhe mendjet tona, mendoj se për pasojë edhe ëndrrat janë të krijuara nga Zoti, - tha ajo.

- Në shkollë nuk kemi mësuar asnjë gjë të tillë të ngjashme. Nga i di ti të gjitha këto? - pyeti ai.
- Këto gjëra nuk mësohen në shkollë. Në fakt as te Njerëzit e Vjetër nuk janë mësuar në shkollë. Përkundrazi, në shkollë vetëm këto gjëra nuk mësohen për të mos thënë mësohen gjëra për të kundërshtuar këto çështje, - tha ajo me njëfarë inati të mezidukshëm.

- Po ti, nga i di? - pyeti sërish Arsini123.

- Është një mjet që e përdornin Njerëzit e Vjetër. Libër quhet. Në ditët tona nuk përdoret më, - tha ajo, tek në fytyrë ngulmimi i mëparshëm mori nuanca zhgënjimi.

- Po me çfarë ngjason? - vazhdoi ai serinë e pyetjeve, si të qe një fëmijë kureshtar.

- Hmm... Me bllokun e shënimeve që të dhashë atë ditë. Ekzaktësisht. Për të mos thënë që ai është një formë libri. Para shumë vjetësh, dmth., para se të shpikesh dhe të futej në përdorim Kutia, njerëzit kishin si mjet arkivimi dhe mësimi *librin*. Ndërsa tash, në kohët tona, Kutia e ka zëvendësuar prej kohësh librin, e ka zhdukur përfare nga qarkullimi dhe Zëri i Këndshëm, duke parë *efikasitetin* që sillte ky mjet, e ndaloi me ligj. Megjithatë, në atë kohë, një libër para se të regjistrohej, dmth., para se të shtypej (kjo është fjala që Njerëzit e Vjetër përdornin për të regjistruar gjërat), ai shkruhej me dorë. I ke parë ato çka unë kam shkruar në bllokun e shënimeve, ato me vijat e lakuara, janë pikërisht ato gërma me të cilat shkruanin Njerëzit e Vjetër.

- Pra, të gjitha këto që po më thua i ke mësuar duke lexuar ato... si e kishin emrin... *libra*? - vazhdoi të pyeste ai.

- Të gjitha, - tha ajo.

- Edhe ato që ke shkruar në bllokun e zi? - pyeti Arsini123.

- Në njëfarë forme. Sepse kur njeriu lexon, pra kur njeriu dhe jo Kutia, sepse ajo duhet shkëputur në kohën kur po lexon, ngaqë dijet dhe informacionet *interferojnë*, dua të them përplasen dhe, duke e bërë këtë, disa herë interferimi do të sinjalizojë sektorin dhe, mandej, edhe Zërin e Këndshëm. Pra, po thosha se këto dije, nuk është se të kujtohen saktësisht siç i ke marrë në libër. Kjo formë e përpiktë ndodh vetëm

te Kutia. Ndërsa libri ka tjetër mënyrë funksionimi, tjetër formë pune. Disa thonë, - ata që kanë shkruar libra, - se libri ka frymë, pra një gjë të pashpjegueshme që lidhet me njeriun. Pikërisht për këtë, ato dije nuk riprodhohen, ato të vijnë në forma të tjera, domethënë të tjetërsuara ose të rafinuara, dhe në fund, kur në një rast ato të duhen, siç po të flas unë tani, duket qartë se nuk dalin nga Kutia, por nga unë, ose nga një gjë më e thellë se unë.

Teksa Ivana123 po i jepte këtë shpjegim, ai ia kishte ngulur sytë, sikur të qe një vorbull, e cila çdo përpjekje për t'u shkëputur prej saj ta kthen me një tërheqje edhe më të fortë. Në ndërkohë, ai u meh për disa sekonda, që në fakt ngjanin si minuta dhe teksa Ivana123 po i jepte kohë ta përtypte dhe ta gëlltiste gjithë këtë informacion të ri, e rimblodhi veten dhe ia ktheu:

- Si ta di unë se të gjitha këto janë të vërteta? Dhe si ta di unë se ti nuk je duke bërë atë që sapo më shpjegove, duke parë një vizion apo duke parë një ëndërr? - dhe pas një qëndrimi të shkurtër ashtu si i ndërlymë dhe, ndërsa ajo po mprihej t'i jepte një përgjigje që të bënte *sens* ai vazhdoi edhe më:

- Në shkollë na kanë thënë, që bisedat me njerëz jospecialistë duhet t'i marrim me rezerva dhe, në fund të fundit, nëse ato nuk përkojnë me informacionet që gjeneron Kutia, ato nuk janë të vërteta.

Fill pasi sosi këtë fjali dhe teksa po këqyrte buzagazin ironik të Ivanës123 shtypi butonin e kontrollit në Kutinë që e sapo e pati nxjerrë nga

xhepi i pasmë. Gjësendi i verdhemë bëri nja tri herë *pip-pip*, dhe në faqen e xhamit të përparmë shfaqti fjalinë “Asgjë nuk u gjet, për më tej kërkoni ndihmë në sektor!”. Ndërkaq sa po lexoi fjalinë që prodhoi pajisja, Arsini123 tha me një ton turfullues:

- Gjepura. Këtu njëri nga ne të dy është çmendur. Ja shikojë çfarë shkruan, - dhe duke i treguar asaj çka shkruante në Kutinë gati sa nuk ia përplasi në hundë. Por ajo nuk u duk aspak e befusuar. Përkundrazi. Po sillej sikur e kishte pritur këtë veprim, me sa duket ishte përgatitur, por sidoqoftë, Ivana123 kishte aftësi të mrekullueshme për ta kontrolluar veten, gjë e cila është shumë e rrallë te gratë e sotme. Sakaq ajo me po atë ftohtësi të shtruar iu përvesh:

- Gjepura janë ato çka ti ke mësuar në shkollë. Gjepura janë krejt çka të kanë thënë prindërit e tu. Gjepura janë krejt ato çka ke dëgjuar për Zërin e Këndshëm, madje edhe vetë ai, Zëri i Këndshëm, është një gjepur e madhe. Një gjepur më të madhe sesa ky Zëri i Shpifur, nëse do ta dish, është Qyteti i Blertë. Se nuk ka qytet më të pablertë sesa ky, madje dhe fjala blerim nuk ka në thelb këtë kuptim që ti dhe miliona njerëz si puna jote e dinë. Por kjo nuk është asgjë krahasuar me gjepurën më të madhe. A e di ti, por në fakt s'ke nga ta dish, se po ta dije do të ishe në një hall tjetër, që gjepura më e madhe është kjo që unë, ti dhe miliona njerëz mbajmë në xhepat tanë, - dhe ndërkaq nxori Kutinë e vet nga xhepi i pasmë dhe e vendosi mbi tavolinë.

Arsini123 e këqyrte si i fantaksur, kur ajo i fliste për Kutinë, për historinë e saj, për funksionet e saj dhe për dobinë ose më saktë për mosdobinë që ajo sillte në jetën e tyre. Ndërkaq Ivana123 ishte kredhur në mendimet e saj dhe, ndërsa i shprazte fjalitë si breshëri plumbash, me një ritëm dhe saktësi të përpiktë, madje me një ngulm po aq të fortë, sa mësuesja e tyre e Sistemit të Transmetimit të Fishave në Shkollën e Detyrueshme. Duke mbajtur këtë leksion me tërë qenien e vet përpara asaj qenieje, që e donte me gjithë shpirt, ajo e kapi zërin e saj me një volum përtej arsyes dhe, sakaq, pasi e stabilizoi me një të krehur në fyt rinisi:

- A e di se çfarë të ka shkaktuar kjo ty? - pyeti tek e shtrëngonte në dorë Kutinë.

Dhe pasi mori frymë vazhdoi:

- Të ka fshirë mendjen, të ka zeruar kujtesën. Shkurt: ta ka bërë të pamundur të kesh kujtesë.

- Ta thash që më parë që këto janë gjepura, - kundërshtoi ai.

- Ja, po të bëj një pyetje të thjeshtë, sa për fillim: si e ka emrin gjyshi yt? - e vuri në provë Ivana123. Arsini123 heshti. Sikur u trullos edhe më. Një tis i verdhë ia kishte mbuluar fytyrën dhe dukej sikur që pikur e rënë nga një tjetër univers; sikur gjëja më e habitshme që kishte parë në këtë botë të huaj që e dashura e vet, të cilën e kishte përballë. Ashtu siç e kishte Kutinë mbi tavolinë, shtypi sërish butonin e kontrollit në seksionin e familjes dhe sërish gjësendi